



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 558/Prot.

Tiranë, më 6.04.2017

VENDIM

Nr. 59, datë 6/4/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

VËREN:

Ankuesi Qendra "BIRN Albania", përfaqësuar nga z. në cilësinë e kryeredaktorit, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankesën nr.558 Prot. datë 24.03.2017 me objekt, "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare" ndaj Autoritetit Publik "Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Me datë 24.02.2017 Qendra "BIRN Albania" ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion, me objekt si më poshtë:

- *Kopjet e akteve të kontrollit për farmacitë dhe agjencitë farmaceutike në vitet 2015 dhe 2016;*
- *Planet e punës dhe programet e kontrollit të dala në zbatim të tyre nga Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik;*
- *Kopje e kontratës midis Fondit dhe 10 subjekteve me vlerat më të larta në rimbursim për vitet 2015 dhe 2016;*
- *Listën e 10 subjekteve me shumën më të lartë në rimbursim, shumën e rimbursimit për secilin subjekt;*
- *Listën e 10 barnave me shumën më të lartë në rimbursim.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 96 datë 29.03.2017 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e ankesës.

Gjatë inspektimit u komunikua me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik e cila sqaroi se nuk ka marrë dijeni për kërkesën objekt shqyrtimi administrativ.

Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”), Autoriteti Publik cakton një prej nëpunësve si Koordinator për të Drejtën e Informimit i cili në përmbushje të këtij funksioni ushtron kompetencat sipas pikës 2 të këtij neni dhe konkretisht bashkërendon punën për zbatimin e së drejtës së informimit, regjistron kërkesat për informacion në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve duke iu caktuar një numër rendor etj.

Kërkesa për informacion është regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit me nr. 982 Prot., datë 27.02.2017, por titullari nuk ka vënë në dijeni Koordinatorin dhe për rrjedhojë kërkesa nuk është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe të Përgjigjeve.

Në bazë të nenit 11, pikat 1 dhe 2, kërkesat për informim regjistrohen pranë Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke iu caktuar një numër rendor i cili i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar sipas nenit 11, pika 2 e Ligjit Për të Drejtën e Informimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 deri në 300.000 lekë.

Nga inspektimi rezultoi se kërkesa është sigluar nga titullari i Autoritetit Publik për ndjekje nga tre drejtori, Drejtorja Juridike, Drejtorja e Çmimit dhe Rimbursimit të Barnave dhe Drejtorja e Kontrollit Parësor Farmaceutik.

Duke mos e vënë Koordinatorin në dijeni lidhur me kërkesën për informacion dhe duke ia kaluar atë drejtorive të tjera për veprim, titullari i institucionit ka veshur kompetencat që sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit (neni 10) ushtrohen nga Koordinatorin.

Ky veprim pasjell për titullarin e institucionit edhe ngarkimin me përgjegjësinë administrative që ligji parashikon për Koordinatorin në rast mospërmbushje të detyrave të përcaktuara në ligj.

Grupi i inspektimit, konstatoi se Autoriteti Publik nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës për informim brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në bazë të në nenit 15 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve punë nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e Ligjit Për të Drejtën e Informimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Në përfundim të inspektimit u parashtruan faktet dhe u hartua procesverbali, i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik.

Pas shqyrtimit të ankesës, kryerjes së inspektimit, shqyrtimit të provave të administruara si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Qendra “BIRN Albania” përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, ku *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Komisioneri vlerëson se për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit (nenit 15) përbën kundërvajtje administrative dhe si e tillë sanksionohet me gjobë sipas nenit 18 të tij. Siç është parashtruar më sipër, në kushtet kur kompetencat e koordinatorit janë ushtruar nga vetë titullari i institucionit z. _____, edhe përgjegjësia për shkeljet administrative të konstatuara gjatë inspektimit do t'i ngarkohet këtij të fundit. Në lidhje me ankimin e Qendrës "BIRN Albania", kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) dhe e) të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjën b) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____ ndaj Autoritetit Publik "Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor" për vënien në dispozicion të ankuesit të dokumentacionit të kërkuar (sipas kërkesës për informacion datë 24.02.2017 regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit me nr. 982 Prot., datë 27.02.2017).
3. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik, Z. _____, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u dha sot në datë 6 . 4 .2017.

